

**National  
Literacy  
Trust**

Change your story



# Historia e tyre fillon me ju

Duke I folur dhe duke e dëgjuar fëmijën tuaj e ndihmon atë në ndërtimin e aftësive të tij komunikuese që në fillim.

Përdorni këto kartat për të shfrytëzuar në maksimum momentet e vogla të përditshme së bashku.

**E**  
Përshtatshme  
për familjet  
me fëmijë të  
moshës  
10–24 muaj.

Në partneritet me

**Better  
Health**

**Start  
for Life**



# Procesi i veshjes

Kur jeni duke veshur fëmijën tuaj, emërtimi i pjesëve të trupit dhe rrobave që po i vishni e ndihmon atë të mësojë fjalë të reja.

## Këshilla për të biseduar gjatë procesit të veshjes:

Përpiquni të përdorni fjalë përshkruese.

**"Më pëlqen bluza jote jeshile me vija."**

Vini në dukje pjesë të ndryshme të trupit.

**"Kapelen do ta mbajmë në kokë"**

Jepini fëmijës tuaj mundësi zgjedhjeje.

**"A të pëlqen të veshim bluzën me vija apo bluzën me pika?"**





# Orari i vakteve

Gjatë vakteve, bisedimi për atë që fëmija juaj po ha dhe çfarë po bën i ndihmon ata të kuptojnë domethënien e fjalëve.

## Këshilla për të biseduar gjatë vakteve:

Hani së bashku kur keni mundësi dhe flisni për ushqimin.

*"Më pëlqen kjo banane. Është e butë!"*

Përsëritni të njëjtat fjalë ose fraza.

*"Unë po e vendos ushqimin në një tas. Ja ku është tasi yt."*

Nxieni fëmijën tuaj që t'ju ndihmojnë me punët.

*"A do të më ndihmosh të përziejmë ushqimin së bashku?"*





# Në shtëpi

Duke biseduar me fëmijën tuaj  
rreth asaj që secili prej jush është  
duke bërë në shtëpi, mund ta ndihmoni  
që të mësojë tingujt dhe fjalët.

# Këshilla për të biseduar në shtëpi

Vini re se për çfarë është i interesuar fëmija juaj.

*"Mendoj së po vendos shumë gjëra në atë kuti, pothuajse e ke mbushur plot!"*

Flisni për atë që ju po bëni.  
*"Le të shkruajmë një listë të gjërave që duhet të blejmë përpara se të shkojmë!"*

Gjeni punë me të cilat fëmija juaj mund t'ju ndihmojë dhe shpjegojini se çfarë janë duke bërë.

*"Tani ti po vendos çorapet në lavatrigë!"*





# Jashtë shtëpisë

Ndërsa jeni jashtë, të folurit  
për gjërat që shikoni do ta  
ndihmojë fëmijën tuaj të  
mësojë fjalë të reja.



# Këshilla për të biseduar kur jeni jashtë

Flisni për atë që shihni.

*“Shikoni autobusin e kuq.  
Ku mendon se po shkojnë  
ata njerëz?”*

Flisni për gjërat që fëmija  
juaj shikon.

*“Ti gjete një kërmill. Të  
shikojmë nëse mund të  
gjejmë më shumë.”*

Përdorni shqisat tuaja për të  
nxitur biseda.

*“Unë dëgjoj gjethet që  
kërcasin. Po ti?”*





# Koha e për tu larë

Bisedimi me fëmijën tuaj kur  
jeni duke e larë, e ndihmon  
atë të praktikojnë nxjerrjen e  
tingujve dhe formimin e fjalëve.

# Këshilla për të biseduar gjatë larjes

Përshkruani se çfarë bën i vogli juaj me lodrat e banjës.  
"Po e derdh ujin. Ishte plot dhe tani është bosh."

Flisni për atë që ju po bëni.  
"Tani do të thajmë gishtat e këmbës. Është i butë peshqiri?"

Përsëritni tingujt dhe fjalët që thotë fëmija juaj.  
Fëmija: "Pop, pop"  
I rrituri: "Pop, pop, ne po nxjerrim të gjitha filluskat."





# Orë e gjumit

Kur bisedoni, tregoni histori dhe këndoni së bashku para gjumit, në këtë mënyrë ju e prezantoni fëmijën tuaj me fjalë të reja.

# Këshilla për të biseduar para gjumit

Nxitini ata të zgjedhin se

çfarë të lexoni.

*"Cilin libër do të lexojmë*

*sonte?"*

Provoni të këndonni një këngë

për fëmijë ose një ninullë.


*"Merimanga e vogël, e egër u*

*ngjit në rubinetin e ujit ..."*

Bisedoni rreth fotove.

*"Gjirafa është shumë e gjatë!*

*Mendon se e nxë këtu?"*



# Këtu janë këshillat tona të preferuara për të ndihmuar fëmijën tuaj që të komunikojë:

- ‘Bisedoni’ me fëmijën tuaj duke iu përgjigjur belbëzimeve, zhurmave, shprehjeve të fytirës dhe lëvizjeve që ai bën. Mos harroni që duhet të ndaloni dhe t’u jepni atyre kohë për t’u përgjigjur kur ju l flisni.
- Shikoni me kujdes se çfarë po ju tregojnë dhe ku po shikojnë, për të mësuar se çfarë u intereson, pastaj bisedoni me ta rreth atyre gjërave.
- Gjeneri mundësi për të folur, kënduar dhe luajtur gjatë gjithë ditës.
- Kur ju shfrytëzoni sa më shumë momentet e vogla duke qënë bashku, ju e ndihmoni në ndërtimin e aftësive komunikuese të fëmijës tuaj që në fillim.

Ky produkt nuk është lodër.

 /nationalliteracytrust



@Literacy\_Trust



@Literacy\_Trust

Për më shumë aktivitete, ju lutemi, vizitoni [word sforlife.org.uk](http://word sforlife.org.uk)

National Literacy Trust është një organizatë britanike e regjistruar nr. 1116260 (Angli dhe Uells) dhe SC042944 (Skoci).